



Raporti Vjetor

2022

ASCAL / SHKURT - 2023

www.ascal.al



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit. ASCAL mbështet veprimtarinë mbi Kodin e Cilësisë në arsimin e lartë dhe standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe në funksion të analizës së ecurisë së punës gjatë vitit 2022, ASCAL harton raportin¹ e përvitshëm analitik në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë kryesore të institucionit.

ASCAL

¹ Ky raport është dokument zyrtar i ASCAL dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin, ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë ASCAL.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
QUALITY ASSURANCE AGENCY FOR HIGHER EDUCATION



Adresa:

Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë, Shqipëri

Kontakt:

Drejtori (Tel/Fax) : 04 2 257954

Spektori i Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë (Tel/Fax): 04 2 266302

Spektori i Statistikave dhe Analizave (Tel/Fax): 04 2 243423

Spektori i Shërbimeve dhe Publikimit (Tel/Fax): 04 2 243423

E-Mail: info@ascal.al

website: www.ascal.al

Shkurtime dhe fjalori shpjegues

- **ASCAL** – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në bazë të ligjit nr. 80/2015;
- **BA** – Bordi i Akreditimit – Organ kolegjal vendimmarrës, i cili akrediton institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, krijuar me ligjin nr. 80/2015;
- **MAS** – Ministria e Arsimit dhe Sportit – Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin në Republikën e Shqipërisë;
- **MPAL** – Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë;
- **IAL** – Institucion i arsimit të lartë – Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, kolegjet universitare, kolegjet profesionale të larta dhe akademitë;
- **PS** – Program studimi – Programe të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë;
- **Vlerësim / Akreditim** – Proces që ndjek ASCAL për të parë përputhshmërinë e një Institucioni të Arsimit të Lartë/programi në kuadër të akreditimit i cili kryhet nga ekspertë të fushës;
- **ENQA** – Rrjeti europian i agjencive për sigurimin e cilësisë (**E**uropean **N**etwork for **Q**uality **A**ssurance);
- **LAL** – Ligji i arsimit të lartë;
- **KC** – Kodi i Cilësisë
- **SKS** – Sondazhi Kombëtar i Studentëve;
- **ESG** – *European standards and guidelines* – Udhëzuesit dhe standardet europiane për sigurimin e cilësisë;
- **CEENQA** – **C**entral and **E**astern **E**uropean **N**etwork of **Q**uality **A**ssurance **A**gencies in **H**igher **E**ducation;
- **EQAR** – The **E**uropean **Q**uality **A**ssurance **R**egister for Higher Education;
- **Koordinator i IAL** – Person kontakti i caktuar nga IAL për komunikimin me ASCAL dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemit elektronik;
- **KT** – Koordinator i Teknik – Përfaqësuesi i ASCAL që ndjek një proces të caktuar të aplikuar nga një IAL;

- **EV** – **E**kspert **v**lerësimi i njohur në një fushë të caktuar i angazhuar nga ASCAL për një proces vlerësimi;
- **AMS** – **ASCAL** Management **S**ystem - Sistemi i menaxhimit elektronik i ASCAL;
- **GVB** – **G**rupi i **v**lerësimit të **b**rendshëm – Personat e angazhuar nga IAL për realizimin e një procesi vetëvlerësimi të institucionit apo programit dhe raportit të vetëvlerësimit;
- **GVJ** – **G**rupi i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Përgjegjës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm;
- **RVB** – **R**aporti i **v**lerësimit të **b**rendshëm – Raporti i vetëvlerësimit i hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të një IAL;
- **DVV** – **D**osja e **V**etëvlerësimit – Dosja me dokumentacionin e plotë që përcillet nga IAL në kuadër të akreditimit të institucionit/programit;
- **DRVJ** – **D**raft**r**aport i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Raporti paraprak i GVJ që i dorëzohet ASCAL;
- **RVJ** – **R**aporti i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Raporti i finalizuar nga GVJ;
- **DPA** – **D**osja e **p**lotë e **a**kreditimit – Dosja me dokumentacionin e plotë e përgatitur nga ASCAL për shqyrtim në BA;
- **VBA** – **V**endimi i **B**ordit të **A**kreditimit – Vendimi i marrë nga BA pas shqyrtimit të DPA të një procesi akreditimi;
- **VKM** – **V**endim i **K**ëshillit të **M**inistrave;
- **UMA** – **U**rdhër i **M**inistrit të **A**rsimit.

TABELA PËRMBLEDHËSE

KAPITULLI I.....	7
INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE	7
1.1. HYRJE	7
1.2 ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	7
1.3 BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	8
1.4 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL / BA	8
1.5 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM.....	10
KAPITULLI II.....	12
VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA	12
2.1 PËRGATITJA/RISHIKIMI I DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESVE TË VLERËSIMIT	12
2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	12
2.3 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT.....	22
2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE.....	26
2.5 AKTIVITETE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRAVE INSTITUCIONALE NË BASHKËPUNIM ME MAS DHE INSTITUCIONET E TJERA NË KUADËR TË INTEGRIMIT EUROPIAN	29
2.6 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË.....	30
2.7 AKTIVITETI FINANCIAR.....	31
KAPITULLI III	44
SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE.....	44
3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE.....	45
3.2 ADMINISTRIMI I PROCESVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË.....	45
3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT.....	47
3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE	49
KAPITULLI IV.....	50
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2023	50

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Gjatë vitit 2022 ASCAL dhe BA kanë synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, shtrirjen e procesit të akreditimit në programet e studimit të ofruar nga IAL-të publike si dhe përfshirjen e studentëve në sa më shumë hallka të sigurimit të cilësisë.

Gjatë këtij viti ka avancuar më tej procesi i akreditimit institucional dhe të programeve të studimit ofruar nga IAL-të publike e private, por në të njëjtën kohë është rritur edhe numri i aplikimeve nga IAL-të publike për akreditime programesh studimi.

Aktivitetet kryesore të realizuara nga ASCAL dhe BA në vitin 2022 janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë raport analitik i cili bazohet në referenca dhe të dhëna empirike. Çdo e dhënë apo informacion i paraqitur në këtë raport mund të përdoret për qëllime informimi dhe studimi, por në asnjë rast ato nuk mund të keqpërdoren, tjetërsohen apo nxirren jashtë kontekstit për të cilin janë paraqitur.

ASCAL

KAPITULLI I

INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE

1.1. HYRJE

Hartimi dhe publikimi i “Raporti Vjetor 2022” të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Bordit të Akreditimit (BA) rrjedh si detyrim nga pika 21/h e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar. Në zbatim të këtij detyrimi ASCAL harton raportin vjetor, ia paraqet për shqyrtim dhe miratim BA dhe më pas e publikon në faqen zyrtare të institucionit². Përveç përmbushjes së detyrimit ligjor, ky raport hartohet edhe në funksion të analizës së punës së ASCAL/BA.

Ky raport paraqet një përmbledhje analitike të veprimtarisë së ASCAL /BA vetëm për vitin 2022, pasi raportet paraardhëse mbulojnë veprimtarinë e viteve përkatëse.

1.2 ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

ASCAL është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Agjencia fillimisht është krijuar me VKM Nr. 303, datë 01.07.1999³ si Agjencia e Akreditimit, riorganizuar në Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me VKM Nr. 424, datë 02.06.2010⁴, dhe riorganizuar në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me VKM Nr. 109, datë 15.02.2017⁵, të ndryshuar.

Agjencia ka si mision promovimin dhe sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë bazuar në disa parime themelore si: **(1)** respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të institucioneve të

² Raporti vjetor për vitin 2022 u shqyrtua dhe miratua nga BA me vendimin Nr. 39, datë 04.03.2023 dhe është publikuar në faqen zyrtare të ASCAL, ku mund të gjenden gjithashtu të publikuara edhe Raportet e viteve të mëparshme.

³ VKM nr. 303, datë 01.07.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”.

⁴ VKM nr. 424, datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”

⁵ VKM nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, ndryshuar me VKM Nr. 825, datë 24.12.2021.

arsimit të lartë (IAL); **(2)** transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit; **(3)** mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL; **(4)** objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe **(5)** respektimin e kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë si dhe të standardeve Europiane të cilësisë. Në veprimtarinë për përmbushjen e misionit të saj, Agjencia gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit të lartë.

1.3 BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

Pranë ASCAL funksionon Bordi i Akreditimit si organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij. BA është vazhdues i punës së Këshillit të Akreditimit⁶ i krijuar në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007.

Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e BA rrjedhin prej Ligjit 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar. Bordi i Akreditimit ka pavarësi në funksionimin e tij përsa i përket akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë.

BA përbëhet nga 11 anëtarë të cilët janë personalitete të botës akademike me eksperiencë në fushën e akreditimit, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit. Ligji Nr. 80/2015 i jep fuqinë BA-së të marrë vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë. BA bashkëpunon me institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë, politikëbërjes dhe vendimmarrjes duke dhënë rast pas rasti rekomandime për çështje të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Aktiviteti i BA mbështetet nga ASCAL.

1.4 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA

Organizimi dhe funksionimi i ASCAL

Struktura e Agjencisë në vitin 2022 është në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 20, datë 26.01.2021 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”*. Agjencia është organizuar në katër sektorë dhe numri i punonjësve është 19. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Sektori i Statistikave dhe

⁶ Për here të parë Këshilli i Akreditimit është krijuar me VKM nr.303, datë 01.07.1999.

Analizave, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin. Çdo sektor drejtohet nga përgjegjësi përkatës. ASCAL ofron asistencën teknike për institucionet e arsimit të lartë, BA, ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

Baza ligjore e funksionimit të ASCAL/BA

Në Shqipëri sistemi i akreditimit ka një përvojë mbi 20 vjeçare dhe ka ardhur duke u konsoliduar gradualisht. Disa nga dokumentet/aktet kryesore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e ASCAL/BA janë:

- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*;
- VKM Nr. 109, datë 15.02.2017 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”*, i ndryshuar me VKM Nr. 825, datë 24.12.2021;
- VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”*;
- VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*;
- Urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin të cilat kanë efekte mbi procedurat e ASCAL në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë;
- “Rregullore për funksionimin e brendshëm të Bordit të Akreditimit”, miratuar nga BA me Vendim Ekstra Nr. 1 datë 02.02.2018;
- Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, miratuar nga BA me Vendim Nr. 72, datë 10.09.2022;
- *“Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area”* (Standardet dhe udhëzimet të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, ndryshuar në vitin 2015). Këto standarde janë

reflektuar në dokumentet bazë të funksionimit të ASCAL si procedura të vlerësimit /akreditimit, etj.;

- Manuali për procedurat e akreditimit të institucioneve dhe të programeve të studimit, miratuar në vitin 2015 dhe rishikuar në vitin 2017 si dhe aspekte dhe procedura të miratuara nga BA.

1.5 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në ushtrimin e veprimtarisë funksionale në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL dhe BA angazhojnë ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë. Gjatë vitit 2022 ASCAL dhe BA kanë përditësuar dhe zgjeruar listën e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, vendas dhe të huaj, bazuar në kualifikimet e tyre si dhe aftësinë për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

Në vitin 2022 ASCAL ka patur në dispozicion një databazë me **880 ekspertë** vendas dhe të huaj të fushave të ndryshme të cilët janë angazhuar rast pas rasti sipas nevojave. Edhe gjatë këtij viti është vijuar me përfshirjen dhe angazhimin e ekspertëve të huaj në akreditimin institucional dhe të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë (sipas përcaktimeve ligjore). Në koordinim të vazhdueshëm, ASCAL dhe BA kanë pasuruar/përditësuar listën me ekspertë të huaj, sidomos të atyre që vijnë nga diaspora akademike shqiptare.

Në këtë kuadër, në muajin Gusht të vitit 2022, pas dakordësimit nga BA, u hap një thirrje për të rekrutuar ekspertë të rinj për vlerësimin e jashtëm, thirrje e cila u bë publike në faqen zyrtare e rrjetet sociale të ASCAL, së bashku më kriteret përkatëse. Kjo thirrje u publikua gjithashtu edhe në faqet zyrtare e rrjetet sociale të disa prej partnerëve ndërkombëtarë si: ENQA dhe INQAAHE, si dhe iu dërgua përmes adresave elektronike personelit akademik pjesë të databazës së ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, të disponueshme në sistemin e menaxhimit të ASCAL (AMS), si dhe IAL-ve në vend, publike dhe jopublike, përmes sistemit AMS, për ta shpërndarë tek personeli i tyre akademik.

Ndër kriteret kryesore të përfshirjes së ekspertëve vendas apo të huaj në listën e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit ishin: të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor”, ose “PhD” të fituar jashtë Shqipërisë; të kenë të paktën 5 (pesë) vite përvojë akademike dhe të jetë i/e punësuar si personel akademik me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë, ose institut kërkimor-shkencor; të ketë një sërë studimesh të cilësisë së lartë të botuara në revista shkencore cilësore dhe me impakt

të lartë në fushën e tij/saj të specializimit; të ketë përvojë në mësimdhënie dhe të ketë marrë pjesë (ose drejtuar) në hartimin e programeve të reja të studimit dhe/ose të kurrikulave mësimore në fushën e saj/tij të studimeve; të ketë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë; të ketë njohuri të proceseve të vlerësimit në kuadër të akreditimit institucional, si dhe programeve të studimit në Shqipëri dhe/ose jashtë vendit, etj.

Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, të gjitha aplikimet dhe dokumentacioni shoqërues i janë përcjellë Bordit të Akreditimit, i cili pas shqyrtimit të tyre, do të përzgjedhë e miratojë listën e re të ekspertëve. Lista e re e ekspertëve planifikohet të miratohet në 3 mujin e parë të vitit 2023.

KAPITULLI II

VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA

2.1 PËRGATITJA/RISHIKIMI I DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESIVE TË VLERËSIMIT

ASCAL, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, përgatit dhe përmirëson vazhdimisht, në koordinim me BA, dokumentat dhe formatet e nevojshme për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

Me miratimin e Kodit të ri të Cilësisë së Arsimit të Lartë me Vendim Nr. 824, datë 04.12.2021 të Këshillit të Ministrave, i cili u përafrua pjesërisht me rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017/C 189/03) datë 22 Maj 2017 *“Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 Prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës”*, ASCAL ndërmoi hapa për hartimin e modeleve të reja të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në kuadër të akreditimit.

Për sa më lart, janë hartuar modelet e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe për akreditimin e parë dhe periodik për programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, “Master i shkencave”, “Master i arteve”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, “Doktoratë”, “Specializime afatgjata”.

2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Edhe gjatë vitit 2022, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe i programeve të studimit që ato ofrojnë vijon të jetë aktiviteti kryesor i ASCAL dhe BA. Në këto procese ASCAL dhe BA mbështeten në Kodin e Cilësisë (VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 (për aplikimet deri përpara hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Cilësisë) dhe VKM Nr. 824, datë 24.12.2021), dhe standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Bazuar në Manualin e Procedurave 2017, procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

Faza e aplikimit - shqyrtimi i aplikimeve

Bazuar në Manualin e vitit 2017, IAL-të duhet të aplikojnë për akreditimin institucional ose të programeve të studimit, në formë zyrare dhe nëpërmjet sistemit online të menaxhimit të ASCAL (ASCAL Management System – AMS) brenda periudhës 1 Tetor – 31 Maj.

Në vitin 2022, në ASCAL janë paraqitur dhe **janë shqyrtuar 261 aplikime të reja** për akreditim ose riakreditim. Nga këto: **9 aplikime** për akreditimin institucional të plotë (për herë të parë dhe riakreditim), dhe **252 aplikime** për akreditim programesh.




Figura 1: Aplikime të shqyrtuara në vitin 2022

Bazuar në këto të dhëna rezulton se aplikimet për akreditim në vitin 2022 kanë qenë thuajse në të njëjtin nivel si në vitin 2021.

Specifikisht, gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 9 aplikime për **akreditim institucional**, nga të cilat:

- **3** IAL publike;
- **6** IAL jopublike.




Figura 2: Aplikimet e shqyrtuara për akreditim institucional, 2022

Nga të dhënat e paraqitura, krahasuar me vitin 2021, vihet re një rënie e aplikimeve për akreditim institucional (nga 15 aplikime në vitin 2021 në 9 aplikime në vitin 2022), lidhur kjo me vitet e akreditimit dhe kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit të dhënë në vendimin e fundit të akreditimit të Bordit të Akreditimit. Nga këto aplikime, 2 prej tyre janë në kuadër të akreditimit për herë të parë institucional (IAL publike).

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar **252 aplikime** për **akreditim programesh**, nga të cilat:

- **141** aplikime nga **8** - IAL publike;
- **111** aplikime nga **18** - IAL jopublike.




Figura 3: Aplikimet e shqyrtuara për akreditim programesh, 2022

Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 ka patur një rritje të aplikimeve për akreditim programesh nga IAL-të publike (nga 120 aplikime në vitin 2021 në 141 aplikime në vitin 2022) dhe një ulje të aplikimeve nga IAL-të jopublike (nga 128 aplikime në vitin 2021 në 111 aplikime në vitin 2022). Specifikisht, në vitin 2022 aplikimet për akreditim programesh nga IAL-të publike janë rritur me **17.5%** ndërsa aplikimet për akreditim programesh nga IAL-të jopublike janë ulur me **13.3%**.

Sikurse duket edhe nga të dhënat e sipërcituara, ka vijuar ndërgjegjësimi i IAL-ve publike për të aplikuar për akreditimin e programeve të studimit, duke rritur kështu edhe intesitetin e punës së ASCAL gjatë gjithë vitit 2022. Duke qenë se për IAL-të publike akreditimi i programeve të studimit zhvillohet për herë të parë, edhe problematikat me të cilat u përball ASCAL shpesh ishin të reja, por në bashkëpunim me MAS dhe IAL-të e interesuara problemet e hasura janë tejkaluar dhe procesi i akreditimit të parë të programeve të studimit të IAL-ve publike vazhdon të zhvillohet me sukses dhe vijon edhe në vitin 2022.

Përsa i përket llojit dhe ciklit të këtyre aplikimeve, janë shqyrtuar:

- **24** programe studimi me karakter profesional;
- **92** programe studimi të ciklit të parë;
- **105** programe studimi të ciklit të dytë (**44** Master Profesional, **51** Master i Shkencave dhe **10** programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë);
- **1** Master Ekzekutiv;
- **27** Master i Arteve;
- **3** Studime Specializuese Afatgjata.




Figura 4: Aplikimet e programeve, 2022 (cikli/lloji)




Figura 5: Aplikimet e programeve, 2022 (cikli/lloji), IAL publike




Figura 6: Aplikimet e programeve, 2022 (cikli/lloji), IAL jopublike

Krahasimisht me vitin 2021, në vitin 2022:

- Është ulur numri i aplikimeve për programet e ciklit të parë Bachelor (nga 126 në 92) dhe programet e ciklit të dytë Master i Shkencave (nga 59 në 51);
- Është rritur numri i aplikimeve për programet e studimit me karakter profesional (nga 15 në 24), programet e ciklit të dytë Master Profesional (nga 38 në 44), programet e ciklit të dytë Master i Arteve (nga 0 në 27), programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (nga 6 në 10) dhe programeve specializuese afatgjata (nga 1 në 3);
- Ka vijuar të jetë në të njëjtin nivel numri i aplikimeve për programet e ciklit të tretë Master Ekzekutiv (1 aplikim);
- Nuk ka patur aplikime për programet e ciklit të tretë Doktoratë.

Gjatë fazës së shqyrtimit të aplikimeve janë kryer verifikime në disa aspekte.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin institucional*, verifikimet janë bazuar në:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu III “Institucionet e arsimit të lartë”, Neni 17-29; Kreu V “Organizimi akademik dhe administrativ i institucioneve të arsimit të lartë”, Neni 36-56;

- Udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 "*Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë*";
- etj.;

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të themelimit, organizimit dhe funksionimit të IAL-ve;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të institucionit si:
 - përmbushja e kërkesave ligjore të organizimit të institucionit;
 - përmbushja e kërkesave ligjore të strukturës akademike;
 - numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, drejtuesve të IAL, njësisve bazë/kryesore;
 - funksionimi i strukturave të sigurimit të cilësisë;
 - numri i studentëve, programeve/fushave të studimit që ofron institucioni;
- verifikimin mbi masat e marra nga institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Në aplikimet e shqyrtuara për akreditim **institucional** janë hasur disa problematika që kanë rezultuar në pezullimin e procesit të akreditimit për 1 (një) IAL. Në çdo rast, ASCAL ka qenë në komunikim me IAL-në dhe MAS për sqarimin dhe përmbushjen e kriterëve ligjore përpara nisjes së procesit të akreditimit.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin e programeve të studimit*, verifikimet janë kryer në dy nivele:

- në nivel institucioni, sipas elementëve të sipërcituar, duke patur në fokus edhe vlefshmërinë e akreditimit institucional;
- në nivel programi për të cilin është aplikuar.

Verifikimet në nivel programi janë bazuar në:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu VII “Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69-73, 77, 79-84;
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndyshuar;
- VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, etj.

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të hapjes, organizimit dhe funksionimit të programit të studimit;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të programit si:
 - përmbushjen e kërkesave ligjore të organizimit/strukturës së programit të studimit;
 - përputhshmërinë e fushës e drejtimeve të IAL/njësisë kryesore/njësisë bazë me programin e studimit;
 - përputhshmërinë e emërtimeve të programit të studimit me aktet që lidhen me organizimin/ funksionimin e tij;
 - numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, të njësisë bazë/kryesore që ofron programin e studimit;
 - numri i studentëve për programin e studimit;
- verifikimin mbi masat e marra nga Institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Nga shqyrtimi i aplikimeve për akreditimin e programeve të studimit gjatë vitit 2022 janë hasur një sërë problematikash (përgjithësisht në aplikimet e IAL-ve publike), lidhur kryesisht me mungesë informacioni/dokumentacioni, mospërputhje të emërtimeve të programeve, etj., të cilat janë zgjidhur duke komunikuar me IAL-të përkatëse dhe MAS, si dhe në 6 (gjashtë) raste kanë rezultuar në pezullimin e procesit të akreditimit për sqarimin dhe përmbushjen e kriterëve ligjore përpara nisjes së procesit të akreditimit.

Gjithashtu, në vitin 2022 ka patur dhe 2 (dy) raste të tërheqjes së vetë IAL-së nga aplikimi për procesin e akreditimit (1 IAL publike dhe 1 IAL private).

Faza e aplikimeve është përmbyllur me miratimin e kërkesës dhe periudhës së vlerësimit, e cila i bëhet me dije IAL-ve sipas parashikimeve të Manualit 2017.

Faza e vlerësimit – vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, procesi kalon në fazën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

Vetëvlerësimi përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë bazohet në përgatitjen dhe paraqitjen e të dhënave institucionale, hartimin e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dokumentacionit mbështetës/verifikues të vlerësimit. Në këtë kuadër, IAL-të dorëzojnë dokumentet përkatëse që përbëjnë Dosjet e Vetëvlerësimit (DVV). Dokumentacioni paraqitet në 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, programeve të integruara të ciklit të dytë si dhe të programeve të ciklit të tretë të studimeve.

Me miratimin e Kodit të Cilësisë në Dhjetor 2021, të gjitha aplikimet për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit të mbërritura në ASCAL nga Janari 2022 e në vazhdim, vlerësohen përkundrejt standardeve të miratuara në këtë Kod. Për këtë arsye, disa prej institucioneve kanë kërkuar trajnimin e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, trajnim i cili iu është ofruar nga ASCAL.

Vlerësimi i jashtëm, bazohet në analizën, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vlerësimin përmes vizitës në institucion. Grupet e vlerësimit të jashtëm kanë vlerësuar dhe dakordësuar gjykimet pjesore e tërësore për të gjitha institucionet dhe programet e vlerësuara në mënyrë kolegjiale. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni është pasuar me vizitën në institucion dhe hartimin e raportit përfundimtar bazuar në dy komponentët e vlerësimit. Grupet e vlerësimit kanë kryer vizita 2-ditore në IAL-të përkatëse për çdo proces, ku kanë zhvilluar takime sipas agjendave të dakordësuara dhe dërguar paraprakisht institucioneve.

Në përfundim, grupet e vlerësimit të jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit të cilat u janë dërguar institucioneve për komente apo sqarime. Proceset janë përmbyllur me hartimin e raportit përfundimtar i cili, përveç pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “gjetjet” e vlerësimit ku përfshihen pikat e forta, të dobëta dhe rekomandimet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Mbështetur në rezultatet e vlerësimit përkundrejt standardeve, ekspertët japin gjykimet e tyre në lidhje me fushat e veçanta dhe vlerësojnë shkallën e përmbushjes e Standardeve të Cilësisë sipas kategorive:

- *Nuk përmbushen;*
- *Përmbushen pjesërisht;*
- *Përmbushen kryesisht;*
- *Përmbushen plotësisht.*

Gjatë vitit 2022, në ASCAL janë përfunduar **123 procedura**, nga të cilat: **09** akreditime institucionale dhe **114** akreditime të programeve të studimit. Të dhënat për procedurat e akreditimit sipas llojit të programeve paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Procedurat e akreditimit sipas llojit të akreditimit Institucional dhe të programeve

Llojet e vlerësimeve	Numri i procedurave të përfunduara, të shqyrtuara në Bord	Numri i procedurave të përfunduara, të pa shqyrtuara në Bord	Totali
Programe me karakter profesional (2 vjeçare)	9	5	14
Bachelor	21	40	61
Master Profesional	4	6	10
Master i Shkencave / Arteve	10	14	24
Master i Shkencave (PI)	0	3	3
SPA	0	1	1
Doktoratë	0	1	1
Akreditime institucionale	1	8	9
Në total	45	78	123

Në kuadër të procedurave të akreditimit, ASCAL ka realizuar trajnime me grupet e vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe grupet e vlerësimit të jashtëm (GVJ). Në këto trajnime grupet njihen me mënyrën e hartimit të raporteve të jashtëm dhe të brendshëm, menaxhimin dhe verifikimin e dokumentacionit për proceset e vlerësimit, organizimin dhe koordinimin e vizitës në institucion, etj.

Gjatë vitit 2022 ASCAL ka realizuar trajnime dhe vizita në institucione si vijon:

- **100 trajnime** për Grupet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit (**85** në IAL publike dhe **15** në IAL jopublike);
- **100 ekspertë** të trajnuar në grup dhe individualisht;
- **250 ekspertë** të angazhuar në kuadër të akreditimeve nga të cilët 50 të huaj dhe 200 vendas;
- **150 vizita** në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit;
- **300 ditë** vizitash të realizuara në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit.

2.3 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT

BA funksionon pranë ASCAL bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017, i ndryshuar dhe ka kompetencën e vendimmarrjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Vendimi për akreditimin mund të jetë pozitiv ose negativ. Në rastin e një vendimi pozitiv, BA shprehet për kohëzgjatjen dhe vlefshmërinë e akreditimit dhe mund të vendosë rekomandime për institucionet në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

Mbledhjet e BA organizohen në bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar.

Në lidhje me aktivitetin e BA, disa nga veprimtaritë kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2022 janë si vijon:

- *Shqyrtimi dhe vendimmarrja në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;*
- *Shqyrtimi i aplikimeve dhe miratimi i listës së ekspertëve;*
- *Organizimi/pjesëmarrja i aktiviteteve në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.*
- *Miratimi i manualit dhe pyetësorit për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2022*
- *Hapja e thirrjes për ekspertë të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit.*

Gjatë vitit 2022, Bordi i Akreditimit ka realizuar **9** mbledhje nga të cilat **3** kanë qenë online.

Në mbledhjet e realizuara BA ka marrë vendime si më poshtë:

Tabela 2: Aktiviteti i detajuar i BA

Aktiviteti i BA 2022									
	Mbledhja BA	Vendime	Akreditim IAL				Akreditim programi		Vendime Proceduriale
			Akreditim i Plotë		Akreditim i Pjesëshëm		IAL Publike	IAL Jo-Publike	
			Publike	Jo Publike	Publike	Jo Publike			
	07 Janar	5	2	1			2	0	0
	25 Shurt	11	0	0			5	5	1
	24 Mars	11	2	0			0	9	0
	22 Prill	14	0	0			3	11	0
	03 Qershor	10	0	0			9	0	1
	09 Shtator	12	0	1			0	11	0
	10 Shtator	9	0	0			0	8	1
	04 Nentor	13	0	0			0	13	0
	16 Dhjetor	14	0	0			0	14	0
Total	9 Mbledhje	99	4	2			19	71	3

Tabela 3: Aktiviteti i përmbledhur i BA

INSTITUCIONET	PUBLIKE	JO-PUBLIKE	TOTALI
Akreditime IAL i plotë	4	2	6
Akreditime IAL të pjesëshme			
Akreditime programesh	19	71	90
Tjetër (ndryshim vendimesh, etj)	3		3
TOTALI	23	73	99

Bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017, i ndryshuar, BA shqyrton ankesat/kërkesat e IAL-ve mbi procesin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe shprehet me vendim/shkresë të arsyetuar në lidhje me këto ankesa/kërkesa, duke vendosur pranimin ose mos pranimin e ankesës. Për vitin 2022 BA ka shqyrtuar 22 ankesa/kërkesa dhe është shprehur për secilën me një vendim/shkresë të arsyetuar.

Gjatë vitit 2022 BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar në hapjen e thirrjes për ekspertë të rinj dhe përditësimin e listës me ekspertë vendas dhe të huaj të akreditimit, duke vënë fokusin tek përfshirja e diasporës akademike shqiptare.

Rezultatet e akreditimit të IAL-ve dhe programeve të studimit, raportet e vlerësimit dhe vendimet përkatëse të BA janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL. Në vendimmarrjet e shqyrtuara gjatë vitit 2022, BA ka dhënë **vlerësime pozitive** për institucionet dhe programet e studimit të vlerësuara.

Ndarja sipas kategorive dhe kohëzgjatjes së vlerësimit, jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelat më poshtë.

Tabela 4: Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit

Vendimmarrja për:	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)										
	1	2	3	4	5	6	Tjetër	Total	Mesatarja	Publike	Jo Publike
Akreditim Institucional		1		2		3		6	4.6	4	2
Akreditim i Pjesshëm											
Akreditim Programesh		22	25	23	14	0	6	90	3.1	19	71
Total		23	25	26	14	3	6	96	3.3	23	73

Tabela 5: Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit për programet e studimit

Vendimmarrja për	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)										
	1	2	3	4	5	6	Tjetër ⁷	Total	Mesatarja	Publike	Jo Publike
Akreditim DP		6	9	3				18	2.8	1	17
Akreditim Bsc		1	9	21	10		4	45	4.6	18	27
Akreditim MP			2	2	1			5	3.8		5
Akreditim Msc / MA		3	8	3	3		3	20	3.3		18

⁷ BA është shprehur për akreditimin e programeve të studimit për breza të caktuara të studentëve të regjistruar/diplomuar në to.

Akreditim Msc PI				1		1	2	5		2
Akreditim SPA/DR										
Total		10	28	29	15	8	90	3.6	19	71

Në zhvillimin e aktitetit të tij BA ka patur mbështetjen e ASCAL. Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin, ka mbështetur aktivitetin e BA duke kryer këto funksione:

- Ndjek procedurat të cilat kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e BA;
- Harton draft-agjendën dhe ia përcjell për sugjerime / konfirmim BA;
- Përgatit dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjen e BA, sipas agjendës së mbledhjes;
- Kujdeset për hapjen, mbarëvajtjen dhe përditësimin e procedurës së hapur në sistemin AMS për mbledhjen e BA;
- Mban kontakte me BA duke informuar për çështjet që lidhen me BA;
- Mban procesverbalin e mbledhjes së BA, ia përcjell anëtarëve të BA dhe sigurohet që të siglohet nga të gjithë anëtarët në mbledhjen e rradhës;
- Arkivon dokumentacionin që lidhet me mbledhjet e BA;
- Drafton, zbardh dhe publikon shkresat / vendimet e BA;
- Regjistron certifikatat e akreditimit institucional/programeve të studimit në regjistrin e certifikatave dhe njofton IAL për tërheqjen e tyre.

Përveç vendimmarjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar edhe në një sërë veprimtarish, si më poshtë:

Siç u përmend edhe më sipër, gjatë vitit 2022 BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar në hapjen e thirrjes për përditësimin e listës me ekspertë vendas dhe të huaj të akreditimit si edhe miratimit të metodologjisë, manualit dhe pyetësorit për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2022.

2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Bazuar në ligjin nr. 80/15 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", i ndryshuar, një nga mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i mësimdhënies edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave, nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve. Po ashtu, me anën e këtij sondazhi, vlerësohen edhe aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit të IAL në kuadër të vendimmarrjes dhe politikëbërjes në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Gjatë vitit 2022, ASCAL dhe BA kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me IAL-të dhe të angazhuar në përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme, setit të pyetjeve dhe versionit online për shpërndarjen e pyetësorëve.

Puna për realizimin e SKS ka filluar që në muajin Janar të vitit 2022, me rishikimin e planit të aktiviteteve dhe rishikimin/hartimin e procedurës së posaçme për zhvillimin e SKS në vitin akademik 2021-2022, përshtatjen e fushave, indikatorëve dhe treguesve duke patur parasysh Kodin e Cilësisë, si dhe ndryshimet në vitin e ri akademik si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të disa akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. Për këtë qëllim, u ngrit grupi qëndror i punës me përbërje nga struktura e ASCAL dhe përfaqësues të studentëve të propozuar nga IAL, si dhe u angazhuan ekspertë të jashtëm të cilët asistuan ASCAL në përgatitjen e projektit me periudhën e aktiviteteve dhe realizimin e këtij procesi.

Pas analizës së kryer, grupi i punës, mbështetur edhe nga Bordi i Akreditimit, përgatiti Manualin "*Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve*" dhe pyetësin e "*Sondazhit Kombëtar të Studentëve*", të cilat, së bashku me Planin e Veprimit me afatet kohore për realizimin e SKS, u shqyrtuan dhe miratuan me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 06, datë 25.02.2022.

ASCAL ka bashkëpunuar ngushtësisht me Këshillat Studentorë në institucionet e arsimit të lartë në çdo fazë të SKS. Studentët janë përfshirë në diskutime dhe në dhënien e opinioneve me qëllim përmirësimin dhe thjeshtimin e përmbajtjes dhe procedurave të SKS.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2022, ASCAL ka qenë në kontakt me IAL-të për nisjen e SKS. U njoftuan titullarët e institucioneve për zhvillimin e

SKS dhe iu kërkuar të përgatisin dhe dorëzonin listat e studentëve me kontaktet e tyre.

Në faqen zyrtare të ASCAL u hap seksioni i posaçëm i SKS në të cilin u publikuan informacionet dhe aktivitetet e zhvilluara. Agjencia u angazhua tërësisht në përgatitjen e infrastrukturës, ku përfshihej platforma, databaza, serveri për ruajtjen dhe arkivimin e informacioneve, etj. Njëkohësisht u informuan institucionet me procesin, planin e veprimtarive, si dhe me agjendat për takimet trajnuese/informuese me grupet e punës dhe studentët.

Më datë 01.04.2022 ASCAL filloi turin e takimeve informuese për SKS. Gjatë periudhës **1 Prill – 21 Prill** u zhvilluan **80 takime** me grupet e punës dhe me studentë të IAL-ve përkatëse. U kontaktuan/trajnuan rreth **290 anëtarë** të grupeve të punës të ngritur pranë IAL-ve dhe rreth **3779 studentë** të cilëve u është shpërndarë dhe broshura informuese e përgatitur për këtë qëllim⁸. Takimet janë zhvilluar në të gjithë IAL-të e vendit në 8 qytete (Shkodër; Tiranë; Durrës; Elbasan; Pogradec; Korçë; Vlorë; Gjirokastër). Aktivitetet në kuadër të këtyre takimeve janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL⁹.

Paralelisht me zhvillimin e takimeve informuese, vijoi puna për përgatitjen e infrastrukturës për zhvillimin e SKS. Gjatë periudhës **28 Mars – 22 Prill, 2022** ASCAL finalizoi versionin online të SKS duke:

- përgatitur në platformë pyetësorin në tre gjuhë: shqip/anglisht/italisht;
- përgatitur formatet e komunikimit me studentët: teksti hyrës i sondazhit; formatet e ftesës, email konfirmimi; email kujtese, etj;
- kryer testet e nevojshme me pyetësorin online;
- krijuar pyetësorët e dedikuar për çdo IAL;
- krijuar llogari për akses individual të studentëve, etj.

Në datën **25 Prill 2022** u hap zyrtarisht dhe u shpërnda SKS me email në adresat e studentëve në 39 Institucione të Arsimit të Lartë në vend (14 IAL publike dhe 25 IAL jopublike). Gjatë periudhës së plotësimit të Sondazhit, ASCAL ka mbajtur komunikime të vazhdueshme nëpërmjet AMS me koordinatorët e IAL-ve, ku i ka informuar për nivelet e pjesëmarrjes dhe ka kërkuar prej tyre marrjen e masave për informimin e vazhdueshëm të studentëve për zhvillimin e SKS.

⁸ https://ascal.al/media/documents/Lajme/sks2022/Fletpalosje_pyetesor_2022.pdf

⁹ <https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/takimet-informuese/takimet-informues-2022>

Gjatë fazës së plotësimit të SKS, studentët kanë patur ndihmën e ASCAL nëpërmjet komunikimeve në adresat e email survey@ascal.al dhe info@ascal.al, ku kanë mbërritur komunikime të ndryshme nga studentë të cilët janë ndihmuar/sqaruar nga ASCAL për zgjidhjen e problematikave të hasura prej tyre, të lidhura kryesisht me probleme teknike për aksesimin e sondazhit, apo ankesa se nuk u ishte dërguar email për plotësimin e sondazhit. ASCAL u është përgjigjur të gjithë emaileve të dërguara nga studentët. Për rastet e mungesës së emailit për plotësimin e sondazhit, ASCAL ka bërë verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar që kontaktet e tyre mungonin në listat e dërguara nga IAL.

Në total nga të gjitha IAL-të në vend u vunë në dispozicion 113136 kontakte të sakta studentësh në të gjitha ciklet e studimit. Nga këto e-maile, pas verifikimit të kryer nga ASCAL, rezultoi se 112743 (83616 IAL publike dhe 29127 IAL jopublike), plotësonin kriterin e një adrese e-maili që suportohej nga platforma e SKS.

Gjatë fazës së plotësimit të sondazhit janë zhvilluar veprimtari promovuese në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit, në median audiovizive dhe rrjetet sociale, duke patur në fokus studentët, sensibilizimin dhe informimin e tyre për SKS.

Me qëllim sigurimin e një pjesëmarrjeje më të lartë të studentëve në SKS, u vendos shtyrja e afatit të mbylljes së SKS deri më datë 5 Qershor 2022. Me mbylljen e platformës online, u eksportuan rezultatet dhe filloi përpunimi i tyre, përmes infrastrukturës së përgatitur për përpunimet statistikore sipas përcaktimeve të Manualit.

Të dhënat janë marrë në shqyrtim dhe i janë nënshtruar analizave për t'u bërë pjesë e një raporti ku do të paraqiten rezultatet në mënyrë të përmbledhur. Gjatë vitit 2022, ASCAL dhe BA kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për strukturimin dhe finalizimin e raportit të SKS. Rezultatet janë shqyrtuar dhe analizuar për t'u bërë pjesë e këtij raporti ku fillimisht jepen rezultate të përgjithshme dhe në anekse janë paraqitur rezultatet e plota për IAL-të sikundër janë dhënë nga studentët. Ky raport analitik është dokumenti me rezultatet dhe konkluzionet që nxirren nga sondazhi i realizuar në institucionet e arsimit të lartë. Raporti i SKS do të bëhet publik në 3 mujorin e parë të vitit 2023, pasi të jetë shqyrtuar e miratuar nga BA dhe do t'i vihet në dispozicion MAS dhe institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.

2.5 AKTIVITETE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRAVE INSTITUCIONALE NË BASHKËPUNIM ME MAS DHE INSTITUCIONET E TJERA NË KUADËR TË INTEGRIMIT EUROPIAN

Gjatë vitit 2022 ASCAL ka marrë pjesë në të gjitha grupet e punës, aktivitetet dhe punën për hartimin e dokumentacionit përkatës, në kuadër të plotësimit të kushteve për anëtarësimin në Bashkimin Europian. ASCAL ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e grupeve të punës, konkretisht në:

1. Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit për periudhën 2021-2026, ku ASCAL ka dhënë një kontribut për kapitujt e Arsimit të lartë;
2. Grupet e punës për rishikimin e VKM 109 datë 15.02.2017, i ndyshuar.
3. Hartimin e dokumentave në kuadër të plotësimit të dokumentacionit për kapitujt 25 dhe 26, të Integrimit Europian:
 - Albanian contribution – updating information to annual report of european commission for albania
 - Analiza e Mangësive ligjore (Legislative Gap Analyses-LGA); Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative (Institution and Administrative Gap Analyses- IAGA);
 - Plani Kombëtar i Integrimit Evropian (PKIE).
4. Pjesëmarrëse si anëtarë të grupit të Shqipërisë Bologna Follow-up Group (BFUG), në të gjitha aktivitetet e organizuara (online);
5. Pjesëmarrje në të gjitha takimet e Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri;
6. Pjesëmarrja në projektin e Komisionit Europian “MICROBOL Working Group on QA”, për mikro kredencialet dhe sigurimin e cilësisë e tyre në Arsimin e Lartë. Pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e organizuara (online);
7. Pjesëmarrja në projektin “Supporting European quality assurance agencies in meeting the standards and guidelines for quality assurance in the European Higher Education Area (SEQA-ESG)”;
8. Pjesëmarrja në takimin menaxherial organizuar në kuadër të projektit ENGINE, në Sofje të Bullgarisë

9. Pjesëmarrje në vizitën studimore tre ditore organizuar nga Universiteti Ku Leuven Technology Ghent Belgjikë, në kuadër të projektit ENGINE.
10. Pjesëmarrje në workshop-in e organizuar nga ENQA në kuadër të projektit “Supporting European QA Agencies in meeting the ESG (SEQA-ESG)”, në Budva të Malit të Zi.
11. Pjesëmarrje në seminarin e organizua nga Iniciativa për Reformën në Arsim të Evropës Juglindore (ERI SEE), në bashkëpunim me Ministrinë e Shkencës dhe Arsimin të Republikës së Kroacisë (MSE) dhe Agjencinë për Shkencën dhe Arsimin e Lartë të Republikës së Kroacisë (AZVO), si dhe mbështetur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), zhvilluar në Zagreb, Kroaci.

2.6 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË

ASCAL është anëtare me të drejta të plota në CEENQA, INQAAHE, dhe anëtare e asociuar e ENQA. Agjencia ka bashkëpunuar aktivisht me këto rrjete, ka marrë pjesë në veprimtaritë e organizuara prej tyre dhe veçanërisht në aktivitetet e organizuar nga ENQA.

Gjatë aktiviteteve ku ka marrë pjesë, ASCAL ka prezantuar dhe informuar bashkëpunorët për aktivitetet që kryen dhe angazhimet për anëtarësimin me të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimin në EQAR. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete kanë qënë objekt diskutimi në ASCAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e Agjencisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 ASCAL ka ndërtuar ura bashkëpunimi me aktorë vendas dhe të huaj për të marrë pjesë si institucion partner në programe të financuara nga Bashkimi Europian që kanë në fokus arsimin e lartë, strukturimin e programeve të studimit dhe kurrikulave, lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës si dhe sigurimin e cilësisë. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2022, ASCAL është bërë pjesë e disa konsorciumeve që kanë aplikuar për financim nga programi Erasmus+ i Bashkimit Europian. Vlen të theksohet se një nga këto konsorciumet udhëhiqet nga ENQA dhe projekti ka si synim asistencën teknike për transpozimin e plotë të ESG-ve në legjislacionin e vendeve si Shqipëria që ende nuk e kanë arritur një gjë të tillë. Në kuadër të këtij projekti të mbështetur nga BE dhe drejtuar nga European Network for Quality Assurance in Higher Education (ENQA). Në kuadër të këtij projekti, për

herë të parë Presidenti i ENQA-s, shoqëruar edhe nga Drejtori i EQAR, vizitoi ASCAL-in, ku u zhvilluan takime me Drejtuesen e ASCAL-it kryetaren e nën kryetaren e Bordit të Akreditimit, si edhe me stafin e Agjencisë. Gjithashtu ASCAL ka nënshkruar dy memorandume të rëndësishme bashkëpunimi, përkatësisht me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe me Agjencinë Kombëtare të Vlerësimit të Universiteteve dhe Sistemit të Kërkimit, të Italisë (ANVUR). Këto memorandume kanë në fokus bashkëpunimin midis agjencive në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave, antarësimit të ASCAL si anëtar me të drejta të plota në ENQA dhe EQAR, angazhimin e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm në mënyrë të ndërsjelltë, etj.

Disa nga konferencat dhe aktivitetet që ASCAL, mori pjesë në vitin 2022 si pjesë e rrjetit të agjencive ndërkombëtare janë:

1. Konferenca e organizuar nga ASIIN me temë “*Rishpikja e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë për kohën tonë - asnjë gur pa lëvizur*”, e mbajtur në Maltë.
2. Workshop i organizuar nga CEENQA me temë “*Pavarësia e Agjencive të Sigurimit të Cilësisë*”, mbajtur në Stamboll, Turqi.
3. Pjesëmarrje në Forumin European të Sigurimit të Cilësisë 2022 (EQAF), organizuar nga West University of Timisoara, Rumani.
4. Pjesëmarrje në Asamblenë e Përgjithshme të European Association for Quality Assurance in Higher Education (ENQA), të zhvilluar në Stockholm, Suedi.

2.7 AKTIVITETI FINANCIAR



Në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, Ligjit “*Për buxhetin e vitit 2019*”, Udhëzimit Nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, të ndryshuar, Ligjit 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë*”, i ndryshuar, ASCAL financohet në mënyrë të balancuar nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj. Nga viti 2019 deri në vitin 2022 nuk janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit, përveç fondit në llogarinë ekonomike 606 një fond, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 989 datë 29.12.2022 “*Për mbështetje financiare të*

menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”, Shkresë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 8489/1 Prot., datë 30.12.2022 “Për shtesë në planin e buxhetit të vitit 2022, Akti Normativ nr.19 datë 29.12.2022”, referuar si më poshtë.

Për pasojë ASCAL ka kryer dhe do të mbështesë aktivitetin e saj financiar për vitin 2022 vetëm nga të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e saj si në tabelën më poshtë:

Tabela 6: Buxheti nga të ardhurat dhe realizimi për vitin 2022

Nr.	Kap.	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani/ lekë	Fakti/lekë	Realizuar në %
1	6	Paga	6000000	40,009,210	15,009,210	37.51 %
2	6	Sigurime shoqërore	6010000	6,232,356	2,332,356	37.42 %
3	6	Shpenzime operative	6020000	133,356,526	38,512,147	28.84 %
4	6	Shpenzime operative	6050000	1,562,346	562,346	35.99 %
5	6	Shpenzime nga fondi i veçantë	6060000	190,000	190,000	100 %
6	6	Shpenzime për investime	2310000	2,615,600	615,600	23.53 %
		Totali		183,966,038	57,221,659	



Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga ASCAL sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e

sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, shpërndahen 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë. Ato evidentohen, autorizohen dhe përdoren me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 6, “Të ardhura jashtë limitit”.

ASCAL trashëgon të ardhura vetëm nga viti 2022, **81,090,773 lekë** dhe të ardhura ndër vite **45,696,106 lekë**, duke siguruar një buxhet për vitin 2023 në vlerën: **126.786.879** lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602, shpenzime operative 605 dhe investime 231.

Tabela 7: Të ardhura të arkëtuara për vitin 2022

Nr.	Kap	Të ardhura	Lloji i të ardhurave	Arkëtuar	Pjesa e Buxhetit	Pjesa e institucionit	Rritje e autorizuar
1	06	7190990	Shërbimet që kryen ASCAL institucioneve të arsimit të lartë	89,959,839	8,995,983	80,963,856	80,963,856
1	06	7211100	Të ardhura nga ENQA	126,917		126,917	126,917
			Totali	90,086,757	8,995,983	81,090,773	81,090,773

Vlerën 80,963,856 lekë (90% të të ardhurave të arkëtuara nga IAL-të) në zërin shpenzime operative, ASCAL-i e përdor në funksion të tyre për:

- Për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, të cilët janë kontraktuar nga ASCAL;
- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Bordit të Akreditimit;
- Për pagesën e anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe shpenzime të tjera të tij;


- Për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare;
- Për pagesat për udhëtime dhe dieta të stafit të ASCAL për aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit;
- Për investime:
 - 12 mujori i vitit 2021 pjesa që i takon institucionit është **60,573,181** lekë;
 - 12 mujori i vitit 2022 pjesa që i takon institucionit është **80,963,856** lekë;

Për vitin 2022 ASCAL ka siguruar të ardhura afërsisht **20,000,000 lekë** më shumë se në vitin 2021.

Tabela 8: Përdorimi i të ardhurave për vitin 2022

Shpenzimet operative / Llogaria ekonomike 602.0000				
Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Gjendja e trashëguar deri me 31 dhjetor te vitit 2021	Përdorur në fakt	% që zë secili zë në totalin e shpenzimeve
1	Shpenzime operative	102,875,265		
2	Shpenzime për pagesën e honorareve të Bordit të Akreditimit (Të huaj dhe vendas)		5,092,965	5 %
3	Shpenzime për pagesën e honorareve të ekspertëve vendas dhe të huaj		18,875,503	18 %
4	Shpenzime udhëtim e qëndrimi brenda dhe jashtë vendit të punonjësve të ASCAL, Bordit të Akreditimit dhe ekspertëve të huaj		5,117,843	5 %
5	Shpenzime të ndryshme, detyrime ndaj të tretëve, qera salle, shtypshkrime, përkthime organizime workshop etj.		7,611,865	7 %
6	Shpenzime për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizatat		572,800	1 %
	TOTALI		37,270,976	36 %

--	--	--	--	--



Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109 datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, në mbështetje të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 35, datë 21.09.20020 të Ministrit të Financave “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjes ndërkombëtare”, ASCAL në muajin korrik 2021 është bërë pjesë e Projektit për ngritjen e kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë, programit bashkëfinancuar Erasmus+ të Bashkimit Evropian “Modernizimi i kurrikulave inxhinierike në energjinë e rinovueshme në universitetet shqiptare”, përmes një marrëveshje partneriteti.

Në projektin me financim të huaj me sistem të plotë thesari (kapitulli 6) Koordinatorin Erasmus+ CBHE EN Gineering Grant Agreement Number: 619338-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP, ka transferuar pjesën e kontributit të grantit Erasmus+ që korrespondon me përfituesin partner ASCAL, në thesar shumën 1,846,060 lekë.

Shpenzimi i realizuar për projektin me financim të huaj për periudhën 12 mujore të vitit 2022 është në shumën 1,584,565 lekë.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2022 për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional si dhe të programeve të studimit janë kryer pagesat për:

A. Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programeve dy vjeçare profesionale:

a. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

- Dip.Prof. “Asistent menaxher”;
- Dip.Prof. “Shërbimi social”;
- Dip.Prof. “Menaxhim biznesi bujqësor”;

b. Kolegji Universitar “Logos”

- Dip.Prof. “Agrobiznes”, me profile:
 - a. Marketing i produktit bujqësor;
 - b. Menaxhim i fermës bujqësore;

c. Kolegji Universitar “Qiriazi”

- Dip.Prof. “Teknologji ushqimore”, me profile:
 - a. Teknologjia e pijeve të ujit;
 - b. Teknologjia e produkteve bimore;
 - c. Teknologjia e produkteve shtazore.
- Dip.Prof. “Teknologji informacioni” me profile:
 - a. Teknologji informacioni dhe komunikim;
 - b. Elektronikë;
 - c. Web Design;
- Dip.Prof. “Hoteleri Turizëm”;

d. Universiteti “Barleti”

- Dip.Prof. “Teknik operacione biznesi marketing dhe shitje”;
- Dip.Prof. “Operator dhe Këshillues në përkujdesje Shëndetësore”;
- Dip.Prof. “Teknik në prodhime digjitale dhe software”;
- Dip.Prof. “Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike”;

e. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

- Dip.Prof. “Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike”;

f. Kolegji Universitar “Bedër”

- Dip.Prof. “Multimedia dhe Dizajn Grafik”;

g. Universiteti Privat “Albanian University”

- Dip.Prof. “Laborant i Lartë Dentar”;

h. Universiteti “Metropolitan Tirana”

- Dip.Prof. “Dizajn dhe Zhvillim Software”;

B. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të parë:

a. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

- Bsc. “Teknologji informacioni”;
- Bsc. “Gjuhë-letërsi”;
- Bsc. “Matematikë-fizikë”;
- Bsc. “Matematikë-informatikë”;
- Bsc. “Administrim biznesi në marketing”;
- Bsc. “Histori gjeografi”;

b. Universiteti “Aldent”

- Bsc. “Teknika laboratorike dentare”;

c. Universiteti “Metropolitan Tirana”

- Bsc. “Inxhinieri elektrike”, me profile;
- Bsc. “Administrim Biznesi”, me profile;

d. Kolegji Universitar “Logos”

- Bsc. “Gjuhë dhe civilizim grek”;

e. Kolegji Universitar “REALD”

- Bsc. “Teknikë laborator në mjekësi”;

f. Universiteti “Barleti”

- Bsc. “Marketing, publicitet dhe marrëdhënie me publikun”;
- Bsc. “Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente”;
- Bsc. “Edukim Fizik dhe Sporte”;
- Bsc. “Punë Sociale”;

g. Universiteti “EPOKA”

- Bsc. “Marketing ndërkombëtar dhe menaxhim logjistik”;

h. Universiteti Europian i Tiranës

- Bsc. “Inxhinieri ndërtimi”;
- Bsc. “Fizioterapi”;
- Bsc. “Inxhinieri Industriale”, me profile;
- Bsc. “Komunikim”, me profile;
- Bsc. “Arsim Parashkollor”, me profile;
- Bsc. “Sociologji”, me profile;
- Bsc. “Edukim Fizik dhe Sporte”, me profile;
- Bsc. “Teknologji Informacioni”;
- Bsc. “Inxhinieri Informatike”;
- Bsc. “Juridik i Përgjithshëm”;
- Bsc. “Imazheri”, me profile;
- Bsc. “Shkenca Politike”, me profile;
- Bsc. “Financë”, me profile;
- Bsc. “Arte Muzikore”, me profile;
- Bsc. “Arte Pamore”, me profile;
- Bsc. “Arte Skenike”, me profile;

i. Universiteti “Polis”

- Bsc. “Inxhinieri Ndërtimi”;
- Bsc. “Shkenca Kompjuterike”;

j. Kolegji Universitar “Wisdom”

- Bsc. “Menaxhim Biznesi”;
- Bsc. “Financë-Bankë”;

k. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

- Bsc. “Administrim Biznes dhe Teknologji Informacioni”;
- Bsc. “Inxhinieri Softuerike”;
- Bsc. “Administrim Biznesi”;

l. Universiteti Politeknik i Tiranës

- Bsc. “Inxhinieri Mekatronike”;
- Bsc. “Inxhinieri Mekanike”;
- Bsc. “Infermieri”;
- Bsc. “Inxhinieri Elektrike” profili “Automatizim i Industrisë”;
- Bsc. “Inxhinieri Elektrike” profili “Energjitik”;
- Bsc. “Inxhinieri të Telekomunikacioneve”;
- Bsc. “Inxhinieri Elektronike”;

m. Universiteti Privat “Albanian University”

- Bsc. “Shkenca Politiko-Administrative”;
- Bsc. “Inxhinieri Elektronike”;

n. Universiteti “Luarasi”

- Bsc. “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”;
- Bsc. “Informatikë Ekonomike”;

o. Universiteti i Tiranës

- Bsc. “Matematikë”;
- Bsc. “Biologji”;
- Bsc. “Bioteknologji”;
- Bsc. “Gjuhë Gjermane”, me profile;
- Bsc. “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
- Bsc. “Filozofi”;
- Bsc. “Shkenca Politike”;
- Bsc. “Kimi”;

C. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë:

a. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

- MP. “Cilësia dhe siguria ushqimore”;

b. Kolegji Universitar “REALD”

- MP. “Menaxhim infermieror”;
- MP. “Fizioterapi”;

c. Universiteti “EPOKA”

- MP. “Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit”;

d. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

- MP. “Auditim i Brendshëm dhe Kontroll Financiar”, me profile;

e. Universiteti Privat “Albanian University”

- MP. “Psikologji Shkollore”;

- MP. “Menaxhim Bankar dhe Financiar”;

f. Universiteti i Tiranës

- MP. “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”;

g. Universiteti “Metropolitan Tirana”

- Msc. “Inxhinieri informatike”;
- Msc. “Ekonomik – MBA”;
- Msc. “Inxhinieri elektrike”, me profile:
 - a. Energjetikë;
 - b. Automatizim industrie;

h. Universiteti i New York-ut në Tiranë

- Msc. “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”;
- Msc. “Psikologji”, me profile;

i. Universiteti “Polis”

- Msc. (PI) "Planifikim dhe menaxhim urban";
- Msc. (PI) Arkitekturë dhe dizajn urban";

j. Universiteti “Barleti”

- MP. “Edukim”, me profil: Mësimdhënia e të Nxënit;
- MP. “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”;
- Msc. “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte”;
- Msc. “Psikologji shkollore dhe zhvillimi”;

k. Universiteti European i Tiranës

- Msc. “Inxhinieri ndërtimi”, me profil;
- Msc. “Fizioterapi”, me profil “Teknika Rehabilitimi”;
- Msc. “Inxhinieri Industriale”, me profile;
- Master i Arteve “Arte Muzikore”, me profile;

l. Kolegji Universitar “WISDOM”

- Msc. “E drejtë civile dhe tregtare”;
- Msc. “E drejtë penale”;
- Msc. “Administrim Biznesi”;

m. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

- Msc. “Inxhinieri Softuerike”;

- Msc. “Administrim Biznesi”;

n. Universiteti “EPOKA”

- Msc. “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”;
- Msc. “Arkitekturë”;
- Msc. “Ekonomiks”;

o. Kolegji Universitar “Bedër”

- Msc. “Drejtësi”, me profile;
- Msc. “Shkenca Kompjuterike”;

p. Universiteti i Tiranës

- Msc. “Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të BE”, me profile;
- Msc. “Politika dhe Qeverisja në Europë”;
- Msc. “Legjislacion dhe Institucionet Europiane”;
- Msc. “Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja”;

q. Kolegji Universitar “Qiriazi”

- Msc. “Financë”;

r. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

- Msc. “Administrim Biznesi”, me profile;

D. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë:

a. Universiteti “Aldent”

- SPA “Stomatologji”, me profile;

b. Universiteti “EPOKA”

- Dr. “Arkitekturë”;

E. Vlerësimi i jashtëm institucional:

- a. Universiteti i Arteve;
- b. Akademia “Ivodont”;
- c. Kolegji Universitar “Qiriazi”;

- d. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;
- e. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;
- f. Kolegji Profesional i Tiranës;
- g. Universiteti “Aldent”;
- h. Universiteti “Metropolitan Tirana”;
- i. Universiteti i Tiranës;
- j. Akademia e Sigurisë;

F. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë, ekspert të huaj;

a. Universiteti i New York-ut në Tiranë

- Msc. “E drejtë ndërkombëtare dhe tregtare”;

b. Kolegji Universitar “WISDOM”

- Msc. “Administrim Biznesi”;

c. Universiteti “EPOKA”

- Msc. “Arkitekturë”;

d. Universiteti i Tiranës

- Msc. “Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të BE”, me profile;
- Msc. “Politika dhe Qeverisja në Europë”;
- Msc. “Legjislacion dhe Institucionet Europiane”;
- Msc. “Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja”;

e. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

- Msc. “Administrim Biznesi”;

f. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

- Msc. “Administrim Biznesi”, me profile;

g. Universiteti “Polis”

- Msc. “Planifikim dhe Menxhim Urban”;

- Msc. (PI) “Arkitekturë dhe Dizajn Urban”;

G. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë, ekspert të huaj:

a. Universiteti “Aldent”

- SPA “Stomatologji”, me profile;

b. Universiteti “EPOKA”

- Dr. “Arkitekturë”;

H. Vlerësimi i jashtëm institucional me ekspertë të huaj:

- Universiteti i Arteve;
- Akademia “Ivodont”;
- Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;
- Kolegji Universitar “Qiriazi”;
- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;
- Kolegji Profesional i Tiranës;
- Universiteti “Aldent”;
- Universiteti “Metropolitan Tirana”;
- Universiteti i Tiranës;
- Akademia e Sigurisë.

ASCAL është pjesë e hapësirës europiane të sigurimit të cilësisë duke bashkëpunuar më të gjithë aktorët e kësaj fushe dhe duke qenë anëtar i asociuar i **ENQA**, anëtar me të drejta të plota i **CEENQA**, anëtar me të drejta të plota i **INQAAHE**. Gjithashtu **ASCAL** ka bashkëpunime të suksesshme me **QAA** dhe **CHE**. **ASCAL** ka paguar tarifën e anëtarësimit në organizmat ndërkombëtare ENQA, CEENQA dhe INQAAHE.

KAPITULLI III
SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE
PROCEDURAVE

3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

ASCAL, në kuadër të përbushjes së detyrave funksionale, monitoron ecurinë e proceseve të ndryshme bazuar në mbledhjen e të dhënave në kohë reale. Bazuar në punën e bërë ndër vite, Agjencia disponon një nga platformat më të rëndësishme të të dhënave në arsimin e lartë e cila përveç mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave mundëson kryerjen online të procedurave në kuadrin e akreditimit të institucioneve/programeve të arsimit të lartë si:

- Menaxhim i procedurave të akreditimit institucional dhe programeve të studimit me ndërfaqe të dedikuara;
- Vlerësime në kuadrin e akreditimeve të para dhe periodike;
- Menaxhim të komunikimeve elektronike e postare;
- Menaxhim shërbimesh nga IAL dhe ndjekje në kohë të proceseve në etapa të ndryshme;
- Komunikim me institucionet dhe ekspertët;
- Realizim i vlerësimit *on-line* për IAL dhe programe nga ekspertë vendas dhe të huaj;
- Plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve;
- Akses për përdoruesit i cili mundësohet nëpërmjet modulit *on-line* me mundësi aksesimi sipas hierarkisë dhe funksionit.

Edhe në vitin 2022 AMS e ka lehtësuar menaxhimin e proceseve të akreditimit pavarësisht sasisë së informacionit të administruar. Në tërësi, AMS, nga IAL-të dhe ekspertët e vlerësimit, ka marrë vlerësim maksimal për lehtësinë, efikasitetin, transparencën dhe mundësitë që ofron për proceset që menaxhohen nëpërmjet këtij sistemi.

3.2 ADMINISTRIMI I PROCESVEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË

Në vitin 2022, nëpërmjet AMS, ASCAL ka realizuar rreth **691** shërbime (akreditime, vlerësime, informime, raportime, etj). Në bazë të *“Manualit për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit”*, janë digjitalizuar të gjitha hapat që ndiqen në një procedurë vlerësimi për akreditimin institucional ose programeve të studimit.

Nëpërmjet AMS, për një procedurë akreditimi janë ndjekur hapat si vijon:

- Aplikimi për akreditim gjatë periudhës 1 tetor – 31 maj, të paktën 1 vit para diplomimit të studentëve të parë për institucionet e reja apo përfundimit të akreditimit të parë ose akreditimit periodik;
- Shqyrtimi paraprak i përputhshmërisë ligjore të kërkesës së akreditimit dhe verifikimi i bazës ligjore të funksionimit të institucionit nga data e themelimit (për institucionet me akreditim të parë) dhe nga data e akreditimit paraardhës;
- Miratimi i periudhës së akreditimit nëpërmjet konfirmimit për fillimin e procesit të akreditimit duke përcaktuar periudhën e akreditimit (datën e fillimit dhe mbarimit të procesit);
- Ngarkimi elektronik i DVV-ve;
- Shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ dhe dërgimi i draft-RVJ-ve dhe i RVJ final.

Gjatë vitit 2022, në çdo hap të procesit të akreditimit, stafi i ASCAL ka qenë në kontakt me koordinatorët e IAL-ve duke shkëmbyer informacione dhe dokumente nëpërmjet AMS. Pavarësisht numrit të madh të aplikimeve për akreditime në 2022, ndjekja në kohë reale e procedurave nëpërmjet AMS ka ndihmuar të gjithë aktorët të koordinojnë aktivitetet duke respektuar afatet kohore dhe njëkohësisht duke rritur transparencën.

Në fillimin e vitit akademik 2022-2023, IAL-të nëpërmjet koordinatorëve dhe në përgjigje të kërkesës së ASCAL, kanë përditësuar informacionin në AMS për stafin e tyre akademik, ndryshimet strukturore, programet aktive dhe jo aktive, studentët që ndjekin studimet për vitin akademik 2022-2023, etj. ASCAL ka shqyrtuar të dhënat e depozituara përkundrejtë standardeve dhe kriterëve për sigurimin e cilësisë dhe kur ka qenë e nevojshme ka kërkuar informacione shtesë ose saktësim të dhënash.


Si rezultat i informacionit të mbledhur ndër vite, aktualisht AMS përbën databazën më të madhe të arsimit të lartë në Shqipëri. Në këtë databazë, vetëm gjatë vitit 2022 janë administruar rreth **3635 dokumente** të ndara sipas llojit, kategorisë, gjuhës, etj. Po ashtu, nëpërmjet AMS, janë regjistruar një numër i madh komunikimesh ndërmjet ASCAL, BA, ekspertëve dhe IAL-ve, si dhe janë shkëmbyer mjaft dokumente shtesë ose informuese. I gjithë informacioni i ruajtur në AMS është lehtësisht i

administrueshëm dhe i përdorshëm në funksion të çdo procesi/procedure dhe aktiviteti të ASCAL dhe BA duke rritur transparencën dhe gjithëpërfshirjen.

Statistika mbi dokumentat e arkivës

E gjithë korespondenca midis ASCAL dhe institucioneve të arsimit të lartë, gjithashtu dhe institucioneve të tjera, ngarkohet në sistemin e brendshëm AMS.

Të shtuara në arkivë janë gjithsej 3635 dokumenta. Në garfikun e mëposhtëm shfaqet shpërndarja e dokumentave sipas llojit.



Dokumentat sipas llojit

3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

ASCAL, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, ndër vite ka ndërtuar një sistem të konsoliduar për dhënie të informacionit dhe informimin e publikut bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ASCAL ka miratuar programin e transparencës dhe e ka publikuar në faqen zyrtare. Ky program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL/BA, nëpërmjet pasqyrit në faqen zyrtare si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit e cila

pasqyron *menu*-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare. Në këtë program transparence ASCAL ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik.

Për **vitin 2022**, referuar regjistrin të dhënies së informacionit, ASCAL u është përgjigjur zyrtarisht dhe ka dhënë informacion/dokumente, për **63 shkresa zyrtare** nga të cilat **10** janë bërë me formular aplikimi, **53** nëpërmjet portalit e-Albania. Shpesh, këto kërkesa, të depozituara nga individë të ndryshëm, kanë patur të njëjtin objekt. Kërkesat për informacion ose dokumente kanë ardhur dhe janë administruar dhe nëpërmjet komunikimeve elektronike, si AMS, *e-mail*, etj.

Stafi i ASCAL gjatë vitit 2022 ka dhënë informacione dhe sqarime të ndryshme edhe nëpërmjet AMS (kryesisht për IAL, BA dhe ekspertët) dhe u është përgjigjur *e-mail*-eve të publikut në tërësi duke u dhënë informacionin e kërkuar ose duke i adresuar në institucionet kompetente.

Në kuadër të transparencës dhe informimit në kohë reale, faqja zyrtare e ASCAL mundëson informacion për publikun dhe palët e interesuara në format të kuptueshëm. Faqja e ASCAL lexon të dhënat në kohë reale nga AMS duke garantuar për publikun dhe palët e interesuara informacion të përditësuar dhe të besueshëm. Edhe në vitin 2022, në faqen zyrtare të ASCAL janë pasqyruar aktivitetet e Agjencisë dhe BA si dhe vendimet për akreditimin e programeve të studimit dhe IAL-ve. Nëpërmjet “*search engine*” në faqen e ASCAL, studentët, publiku i gjerë si dhe palët e tjera të interesuara mund të marrin informacion të plotë mbi vlefshmërinë e akreditimit të programeve të studimit apo IAL-ve, proceset e vlerësimit që kanë kaluar programet e studimit dhe IAL-të si dhe RVJ-të përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga informacionet e të dhënat që i vihen në dispozicion publikut dhe palëve të interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të ASCAL janë:

- Informacion për procesin e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit me të dhëna për çdo proces të zhvilluar nga çdo program studimi dhe IAL;
- Raporte të vlerësimit të jashtëm institucional dhe të programeve të studimit;
- Vendime të Këshillit të Akreditimit dhe Bordit të Akreditimit, urdhëra të MAS, etj.;
- Publikime të akteve/bazës ligjore mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit të jashtëm si Ligji 80/2015, VKM Nr.

109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, etj.;

- Raporte vjetore, rregullore, udhëzues, modele RVB dhe RVJ, etj.

3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit/dokumentacionit në ASCAL zbatohet nga arkiva/protokolli i institucionit. Çdo dokument ruhet në formë fizike dhe elektronike në arkivën dhe databazën e institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”. Në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, ASCAL klasifikon informacionin sipas statusit të tij, *publik, përdorim të brendshëm, konfidencial dhe sekret*. Po ashtu dhe aksesit në dokumentacion për stafin e ASCAL, BA dhe ekspertët, bëhet në funksion të procesit/procedurës së cilës i përket dokumentacioni.

Aspekte të përdorimit të informacionit të brendshëm të ASCAL dhe mënyrës së dhënies së tij, janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

Në funksion të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, së bashku me dosjen e printuar, në ASCAL dorëzohet edhe versioni elektronik i saj.

KAPITULLI IV

PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2023

ASCAL ka si objektiv kryesor (i) sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, (ii) ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe (iii) përmirësimin e cilësisë së IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. ASCAL gjithashtu synon të anëtarësohet në Rrjetin Europian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe të regjistrohet në Regjistrin Europian të Agjencive (EQAR).

Referuar synimeve të mësipërme, gjatë vitit 2023, ASCAL parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

- 1.** Zhvillimi i procedurave/aktiviteteve në kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, specifikisht:
 - a. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit;
 - b. Vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të brendshme të cilësisë në IAL;
 - c. Bashkëpunimi me IAL për mbarëvajtjen e proceseve të vlerësimit të jashtëm;
 - d. Mbështetja e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit;
 - e. Aktivitete në bashkëpunim me aktorë të tjerë në fushën e arsimit të lartë.

Lidhur me sa më sipër ASCAL parashikon të përfundojë të gjitha proceset e vlerësimit të mbartura nga viti 2022.

- 2.** Pjesëmarrje aktive (si partner) në projektet ndërkombëtare në të cilat ASCAL është partner;
- 3.** Përmirësim i kushteve infrastrukturore ku ushtron aktivitetin ASCAL dhe logjistikës në dispozicion të stafit të Agjencisë;
- 4.** Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të funksionimit të Agjencisë, ASCAL do të vazhdojë *marrjen e mendimeve nga ekspertët e huaj dhe vendas të vlerësimit të jashtëm si dhe IAL-të* me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave të Agjencisë.
- 5.** Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me agjenci si motra, anëtare të ENQA-s.
- 6.** Organizimi i workshop-it në kuadër të prezantimit të rezultateve të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

7. Organizimi i workshop-it në kuadër të prezantimit të standardeve të Kodit të Cilësisë.